



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
MINISTRI

Nr. 4295 Prot.

Tiranë, më 24.07.2012

U D H Ë Z I M

Nr. 16, datë 24.07. 2012

**PËR
VITIN SHKOLLOR 2012 – 2013 NË SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të Ligjit Nr. 7952, datë 21.06.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, i ndryshuar,

U D H Ë Z O J:

KREU I

STRUKTURA E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR NË VITIN SHKOLLOR 2012-2013

1. ARSIMI BAZË:

Klasa	Mësim			Festa
	Sem. I	Sem. II	Gjithsej	
I - IX	18 javë	17 javë	35 javë	7 ditë

Mësim:

Semestri i parë fillon më 10 shtator 2012 dhe mbaron më 23 janar 2013;
Semestri i dytë fillon më 28 janar 2013 dhe mbaron më 7 qershor 2013.

Pushime:

Periudha e parë, fillon më **24 dhjetor 2012** dhe mbaron më **6 janar 2013**;
Periudha e dytë, fillon më **24 janar 2013** dhe mbaron më **27 janar 2013**;
Periudha e tretë, fillon më **27 mars 2013** dhe mbaron më **31 mars 2013**.

Provimet e Lirimit zhvillohen në periudhën **10 - 21** qershor 2013.

2. ARSIMI I MESËM

a. Gjinnazi

Klasa	Mësim	Provime të Maturës Shtetërore	Festa
X -XI	36 javë	-	7 ditë
XII	34 javë	5 javë	7 ditë

b. Shkollat e mesme artistike 3-vjeçare dhe koreografike

Klasa	Mësim	Praktikë e grupuar	Provime: Matura Shtetërore	Festa
X - XI	34 javë	2 javë	-	7 ditë
XII	34 javë	-	5 javë	7 ditë

c. Shkollat e mesme artistike 4-vjeçare

Klasa	Mësim	Praktikë e grupuar	Provime të Maturës Shtetërore	Festa
X - XII	34 javë	2 javë	-	7 ditë
XIII	34 javë	-	5 javë	7 ditë

d. Shkollat e mesme sportive

Klasa	Mësim	Praktikë e grupuar	Takime Sportive	Festa
X	34 javë	2 javë	3 javë	7 ditë
XI - XII	32 javë	4 javë	4 javë	7 ditë

e. Arsimi profesional

- **Struktura (2+1+1)**

Klasa	Mësim	Gjithsej	Provime përfundimtare të Nivelit	Festa
X	36 javë	36 javë	-	7ditë
XI - XII	34 javë	34 javë	2 javë	7 ditë
XIII	32 javë	32 javë	2 javë	7 ditë

- **Struktura 2+2**

Klasa	Mësim	Gjithsej	Provime përfundimtare të Nivelit	Festa
X	36 javë	36 javë	-	7ditë
XI	34 javë	34 javë	2 javë	7ditë
XII	36 javë	36 javë	-	7ditë
XIII	32 javë	32 javë	2 javë	7 ditë

- **Struktura 4 vjet bllok**

Klasa	Mësim	Gjithsej	Provime përfundimtare të Nivelit	Festa
X -XII	36 javë	36 javë	-	7ditë
XIII	34 javë	34 javë	2 javë	7ditë

f. Struktura e arsimit të mesëm me kohë të pjeshme (SHMKP):

- **Gjimnazi**

Klasa	Mësim	Gjithsej		Festa
X -XI	36 javë	36 javë	-	7ditë

- **Arsimi profesional**

Klasa	Mësim	Gjithsej	Provime përfundimtare të Nivelit	Festa
X -XI	36 javë	36 javë	-	7ditë

Shënim 1.

- Klasa X dhe XI e SHMKP do të funksionojnë në përputhje me **Udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Nr 35, datë 31.08.2011** "Për strukturën, planin mësimor dhe veprimtarinë mësimore të shkollave të mesme me kohë të pjeshme".
- DAR/ZA-të të zgjasin periudhën e regjistrimit të nxënësve në arsimin profesional me kohë të pjeshme deri më datë 15 tetor 2012.
- **Kriteret e hapjes se klasave me kohe te pjeshme:**
 - ❖ Në gjimnazet ekzistuese me kohe të pjeshme, për këtë vit shkollor, të hapet vetëm një klasë e 10-të, me jo më shumë se 40 nxënës
 - ❖ Në klasat e ndërmjetme të mos bëhen regjistrime të reja
 - ❖ Aplikantët të orientohen vetëm në shkollat profesionale me kohë të pjeshme, në të cilat nuk do ketë kufizime përsa i përket numrit të nxënësve.
- Klasa XII dhe XIII e SHMKP-ve, në vitin shkollor 2012-2013 të zbatojë planin mësimor të miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Nr 5090 Prot, datë 31.05.2009 dhe provimet do t'i zhvillojnë sipas këtij kalendari:

Klasa Muaji	XII	XIII
15 dhjetor 2012	Gjuhë shqipe dhe letërsi Gjeografi TIK	Gjuhë shqipe dhe letërsi Gjeografi TIK
19 janar 2013	Histori Gjuhë e huaj Biologji	Matematikë Gjuhë e huaj Histori
23 shkurt 2013	Fizikë Kimi Qytetari	Ekonomi Edukim për karrierën
23 mars 2013	Matematikë Edukim për karrierën	

Shënim 2.

- Klasa XII të zhvillojë provimet në orën 10.00-12.30.
- Klasa XIII të zhvillojë provimet në orën 14.00-16.30

Mësimi:

Fillon më 10 shtator 2012 dhe mbaron më 14 qershor 2013.

Për maturat mësimi fillon më 10 shtator 2012 dhe mbaron më 24 maj 2013.

Pushime:

Periudha e parë, fillon më **24 dhjetor 2012** dhe mbaron më **6 janar 2013**;

Periudha e dytë, fillon më **27 mars 2013** dhe mbaron më **31 mars 2013**.

Provimet e Maturës Shtetërore: **25 maj – 30 qershor 2013**.

Sesioni i provimeve të Teorisë dhe Praktikës Profesionale të Integruar për shkollat profesionale të vlerësohen me notë, e cila nuk përfshihet në mesataren e përgjithshme:

- ✓ **Nivelin I** dhe **Niveli II 1** deri më **15 qershor 2013**.
- ✓ **Niveli III 11** deri më **22 maj 2013**,

Praktikat profesionale të vlerësohen me notë dhe kredite.

Provimet e formimit teorik dhe praktik në shkollat artistike, sportive dhe gjimnazet gjuhësore të zhvillohen në periudhën **11 deri më 22 maj 2013 dhe të vlerësohen me notë**, e cila nuk përfshihet në mesataren e përgjithshme.

Gjatë vitit shkollor 2012-2013 testimi i drejtuesve të organizohet sipas Rregullores Nr. 7170/1, datë 22.11.2010 "Për kualifikimin e drejtuesve të institucioneve arsimore".

Në periudhat e pushimeve DAR/ZA-të dhe drejtoritë e shkollat të planifikojnë trajnime për drejtuesit dhe mësuesit.

KREU II

KUADRI NORMATIV DHE RREGULLUES I VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONEVE ARSIMORE

Veprimtaria e institucioneve të arsimit parauniversitar të mbështetet në të gjitha urdhërat dhe udhëzimet e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës që janë në fuqi. Në mënyrë të veçantë në:

- Udhëzimin Nr. 10, datë 10.07.2012 "Për masat për zhvillimin e provimeve të sesionit të dytë të MSh 2012".
- Udhëzimin Nr. 21, datë 23.07.2010 "Për normat e punës mësimore-edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar".
- Udhëzimin Nr. 22, datë 29.07.2010 "Për emërimet e personelit mësimor dhe drejtues në arsimin parauniversitar".
- Udhëzimin nr.37, datë 22.11.2010 "Për pranimet në shkollat e mesme të përgjithshme me kohë të shkurtuar dhe me korrespondencë, organizimin dhe njëvlershmërinë e tyre".
- Udhëzimin Nr 23, datë 30.07.2010 "Për njëvlershmërinë e studimeve në shkollat e mesme me kohë të plotë dhe me kohë të shkurtuar, në sistemin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë".
- Udhëzimin Nr. 9, datë 25.02.2010 "Për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave statistikore".
- Udhëzimi Nr 35, datë 31.08.2011 "Për strukturën, planin mësimor dhe veprimtarinë mësimore të shkollave të mesme me kohë të pjesshme".
- Udhëzimi Nr.33, datë 01.11.2010. "Për kriteret dhe procedurat e shqyrtimit të kërkesave për licensë të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare".

- Urdhri Nr. 174, datë 23.05.2007, "Për miratimin e lejes për zhvillimin e veprimtarive jashtëshkollore në institucionet arsimore publike dhe private".
- Urdhri Nr. 326, datë 22.06.2010 "Për hapjen e drejtimit mësimor Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, në disa shkolla të mesme profesionale".
- Udhëzimi i përbashkët Nr 15 datë 23.07.2012 me MPÇSSH për "Funksionimin e bordeve në institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional".
- Urdhri nr 300 datë 23.07.2012 "Për regjistrimin e të dhënave të shkollave profesionale, artistike dhe sportive.
- Rregulloren Nr. 2264/1, datë 05.04.2010 "Për zhvillimin e olimpiadave të lëndëve shkencore në arsimin parauniversitar".
- Rregulloren Nr. 957, datë 15.02.2011 "Për Zhvillimin e provimeve përfundimtare të Nivelit I dhe II të Arsimit Profesional"
- Planet dhe programet mësimore të miratuara nga MASH.

KREU III

FUNKSIONIMI I INSTITUCIONEVE ARSIMORE, PROGRAMET, TEKSTET MËSIMORE DHE VLERËSIMI

1. Arsimi parashkollor

Në zbatim të objektivit të MASH-it për sigurimin e të paktën një viti përgatitor për fëmijët 5-vjeçarë që nuk kanë qenë në kopsht, në të gjithë vendin funksionojnë 400 klasa përgatitore. DAR/ZA-të, drejtoritë e shkollave ku janë hapur klasat përgatitore, të punojnë më përgjegjësi për:

- a) konsolidimin e veprimtarisë mësimore - edukative në klasat përgatitore;
- b) evidentimin e kontingjentin e fëmijëve 5-vjeçarë, e në veçanti të fëmijëve romë, egjiptianë dhe nga shtresa të marginalizuara për t'i regjistruar në klasat përgatitore;
- c) orientimin dhe kujdesin për regjistrimin e fëmijëve 3 deri 5-vjeçarë, me qëllim shfrytëzimin e të gjitha kapaciteteve në kopshtet me dhe pa ushqim;

Në ndihmë të realizimit të procesit mësimor-edukativ në klasat përgatitore dhe kopshtet e fëmijëve, udhëzuesit metodik dhe fletët e punës për fëmijët, sipas grupmohës ndodhen në faqen elektronike zyrtare të MASH.

2. Arsimi bazë

2.1 DAR/ZA-të dhe mësuesit të njihen me draftin e Kornizës së Re Kurrikulare dhe planit mësimor dhe të diskutojnë për këto dokumente;

2.2 Të diskutohen në nivel shkolle, DAR/ZA draftprogramet lëndore;

2.3 Të njihen drejtuesit e shkollave dhe mësuesit me Kodin e Etikës të mësuesve në arsimin parauniversitar;

2.4 Në klasën e nëntë të zhvillohet moduli "**Edukimi për karrierën**", për t'u lehtësuar nxënësve orientimin e tyre për vijimin e arsimit të mesëm, kryesisht atij profesional.

3. Arsimi i mesëm

Në përfundim të ciklit të parë të reformës kurrikulare, DAR/ZA-të dhe drejtuesit e shkollave të mesme të japin ndihmesën e tyre në vlerësimin e zbatimit të kësaj kurrikule. Pjesë e vlerësimit të jenë:

- evidentimi i rezultateve dhe i risive që ka sjellë kurrikula e re;
- Evidentimi i mbingarkesës së krijuar (nqs ka);
- Mendime për listën e lëndëve me zgjedhje të Maturës Shtetërore;
- Projekti kurrikular;
- Krahasimi i rezultateve të Maturës Shtetërore 2012 me rezultatet e maturave të viteve të mëparshme.

3.1 Vlerësimi i nxënësit në gjimnaz

- Numri më i vogël i krediteve që duhet të sigurojë një nxënës në gjimnaz është 90 nga të cilat:
 - 73 kredite i përkasin kurrikulës bërthamë;
 - 17 kredite i përkasin kurrikulës me zgjedhje të lirë dhe të detyruar.
- Numri i krediteve të kurrikulës me zgjedhje të detyruar mund të jetë 10-12, kurse numri i krediteve të kurrikulës me zgjedhje të lirë mund të jetë 7-5;
- Kur një gjimnaz (publik apo privat) zgjedh dhe mundëson të zhvillojë më shumë se 30 orë/javë, lëndët për orët shtesë (mbi 30 orë), përzgjidhen nga kurrikula me zgjedhje të detyruar;
- Në sesionin e dytë, kanë të drejtë të japin provime vetëm nxënësit të cilët kanë mbetur në një ose dy lëndë të vlerësueshme të planit mësimor të vitit përkatës (kurrikul bërthamë dhe me zgjedhje);
- Nxënësi nuk e kalon klasën dhe ripërsërit atë kur:
 - Rezulton mbetës në tre lëndë të vlerësueshme (bërthamë ose zgjedhje);
 - Mbetet në sesionin e dytë, në të paktën një lëndë bërthamë/zgjedhje.
- Nxënësit që mbeten në klasë, nuk i njihen kreditet e fituara në atë klasë, me përjashtim të atyre të fituara për shërbimin komunitar dhe modulet profesionale, të cilat dëshmohen me certifikatë.
- Maturantët nuk mund të futen në provimet e Maturës Shtetërore, kur janë mbetës në një ose dy lëndë të vlerësueshme (bërthamë ose zgjedhje). Këto lëndë mund t'i japin në një periudhë para sesionit të dytë të MSH-së;
- Nxënësit, të cilët kanë plotësuar 20-50% të mungesave të planit mësimor vjetor të lëndës/lëndëve, të merren në provim nga një komision i ngritur nga drejtoria e shkollës dhe nota/notat e tyre të shënohet në kolonën e vlerësimeve me shkrim për secilën lëndë;
- Nota vjetore për çdo lëndë, llogaritet sipas formulës: $V = 0,4 \times M1 + 0,5 \times M2 + 0,1 \times M3$:
 - M_1 , M_2 dhe M_3 janë përkatësisht mesataret aritmetike të vlerësimeve me gojë, me shkrim dhe në projektet kurrikulare lëndore;
 - **V** llogaritet **me një shifër dhjetore** dhe ne amëz pasqyrohet notë e plotë e rrumbullakuar sipas rregullit matematik;
 - Vlerësimi i përshkallëzuar ruhet deri kur nxënësi pajiset me certifikatë të Maturës Shtetërore, e cila ruhet elektronikisht në një folder të veçantë të sekretarisë së shkollës;
 - Kjo formulë do të përdoret edhe për vlerësimin në lëndët e kulturës së përgjithshme në shkollat profesionale, artistike, sportive.
- Vlerësimi me pikë për çdo lëndë bëhet sipas formulës:

$$P_i = V_i \times K_i \times Kr$$
 - P_i është numri i pikëve të një lënde,

- V , është vlerësimi vjetor i lëndës,
- K , koeficienti i lëndës
- Kr numri i krediteve të lëndës.
- Përforcimi, modulet profesionale, sherbimi komunitar dhe projektet kurrikulare ndër-lëndore nuk vlerësohen me notë, pra as me pikë.

Shënim.

- Vlerësimi me pikë i lëndëve të llogaritet me një shifër dhjetore
- Pikët mesatare për kredit llogariten duke pjesëtuar shumën e pikëve të përgjithshme me numrin e krediteve të vlerësueshme. Vlera e këtij treguesi të llogaritet me dy shifra dhjetore.
- Në qoftë se gjimnazi mundëson modulën profesional në ndërmarrje/kompani/firma private apo shtetërore (të cilat japin dhe certifikatë përkatëse), atëherë nxënësit për modulet që kryhen në shkollë, si fotoshop, guidë turistike etj. të vlerësohen me notë, si lëndë me zgjedhje të lirë.
- Në qoftë se modulet fotoshop, guidë turistike etj. gjimnazi i trajton si module profesionale, atëherë të mos vlerësohen me notë. Nxënësit pajisen vetëm me certifikatë të lëshuar nga shkolla. ***Për realizimin e modulit profesional, referojuni Kreut VI, Pika 6 e këtij Udhëzimi.***
- Kjo metodologji do të përdoret edhe për vlerësimin në shkollat profesionale.

3.2 Gjimnazet me orientim gjuhësor

- Gjimnazet me orientim gjuhësor të punojnë me planin mësimor Nr. 1023, datë 17.02.2012, miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.
- Gjimnazet gjuhësore mund ti zgjedhin vetë tekstet shkollore për lëndën e gjuhës së huaj, nëse tekstet e ofruara nga ALTERTEKST 2012 nuk përmbushin kërkesat kurrikulare të këtyre lëndëve.
- Në lëndën e gjuhës së huaj të punohet me grupe në mbështetje të Udhëzimit Nr. 21, datë 23.07.2010 "Për normat e punës mësimore-edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar".

3.3 Seksionet shkollore dygjuhëshe

- Seksionet shkollore dygjuhëshe, edhe për vitin shkollor 2012-2013, të funksionojnë sipas memorandumeve dhe marrëveshjeve të përcaktuara në Udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Nr 31, datë 04.08.2011. DAR/ZA-të dhe drejtoritë e shkollave të respektojnë me rigozitet këto dokumente.
- Në gjimnazet ku funksionojnë seksionet dygjuhëshe, të krijohen ekipet kurrikulare sipas Udhëzimit Nr. 38, datë 11.10.2007 "Per zhvillimin e orëve të lira në shkollë".
- Në shkollat ku funksionojnë seksionet dygjuhëshe, në lëndët ku mësimi zhvillohet në gjuhët e huaja, vlerësimi periodik/përmbledhës i nxënësve të bëhet detyrimisht një herë në muaj dhe jo në më pak se çdo 18 orë.
- Plani mësimor, programet dhe tekstet e zgjedhura që zbatohen në tri seksionet dygjuhëshe, janë bashkëlidhur me dokumentet e nënshkrimit. Për lëndët në gjuhën shqipe të përdoren tekstet e miratuara në katalogun "ALTERTEKS 2012".

3.4 Gjuhët e huaja në arsimin parauniversitar

DAR/ZA - të ndjekin me përparësi:

- a) Sigurimin e zhvillimit të mësimin të gjuhës së huaj në shkollat e arsimit bazë dhe të mesëm që nuk kanë zhvilluar më parë këtë lëndë. **DAR/ZA – të të raportojnë brenda datës 9 shtator 2012 për realizimin e këtij detyrimi.**
- b) Sigurimin e vijmësisë e gjuhës së huaj (të parë dhe të dytë).
- c) Vijimin e zbatimit të programit “Iliria”, duke siguruar kontingjentin e nxënësve që mësojnë gjuhën italiane si gjuhë e huaj e parë.
- d) DAR/ZA –të në varësi të kuadrit mësimor të planifikojnë mësimin e tre gjuhëve të huaja (angleze, frënge dhe italiane) në klasën e tretë të ciklit të ulët duke respektuar funksionimin e shumëgjuhësisë
- e) Sigurimin e mësimin të gjuhës së huaj për nxënësit e klasës XI dhe XII, të cilët nuk kanë zhvilluar gjuhë të huaj gjatë shkollimit të tyre, në përputhje me Udhëzimin Nr. 31, datë 04.08. 2011.

3.5 Tekstet shkollore të paketës Altertekst

- a) Në shkolla të përdoren vetëm tekste shkollore të miratuara nga MASH. Lista e këtyre teksteve jepet në katalogët nr. 1 dhe nr. 2 të publikuar nga MASH për vitin shkollor 2012-2013.
- b) Lista e teksteve shkollore të lëndëve të kulturës profesionale për shkollat profesionale, të lëndëve speciale në shkollat e pakicave kombëtare, të teksteve të veçanta në kurrikulën me zgjedhje të lirë janë publikuar në katalogun nr. 3.
- c) Shitja e librave në shkollat e qyteteve të bëhet në mjediset e shkollave. Nuk lejohet që në këtë proces të marrin pjesë mësues dhe punonjës të DAR/ZA-ve. Drejtori i shkollës dhe punonjësit e DAR/ZA-ve të monitorojnë procesin, duke siguruar një ose dy klasa për shitjen e librave për një periudhë trijavore.
- d) Në bibliotekat e shkollave të jenë të gjitha alternativat e teksteve që do të shërbejnë për përzgjedhje vitin e ardhshëm.

3.6 Arsimi profesional

Zbatimi i skeletkurrikulave për drejtimet/profilet profesionale të nivelit III

a) Për strukturën 2+1+1:

Niveli III ofrohet vetëm me “drejtime mësimore”, pra nxënësit që kanë përfunduar Nivelin II (klasa XII) në një nga “profilet mësimore” të një drejtimi të caktuar, të vijojnë Nivelin III (klasa XIII) **vetëm** në drejtimin mësimor përkatës. P.sh., nxënësit e profileve “Shërbime motorike”, dhe “Shërbime xhenerike”, klasa XII, të vijojnë shkollimin në drejtimin “Shërbime mjetesh transporti”, klasa XIII. Kjo do të thotë që në klasa XIII, nxënësit që përfunduan klasën XII në profile të ndryshme të të njëjtit drejtim, mund të bashkohen në klasa të përbashkëta dhe të ndjekin drejtimin mësimor përkatës në klasën XIII.

b) Për strukturën 2+2:

Niveli III vazhdon me “profile mësimore”. Nxënësit që kanë përfunduar nivelin I (klasa XI) në një nga “drejtimet mësimore”, mund të vijojnë Nivelin III (klasa XII-XIII) **vetëm** në një nga profilet mësimore të këtij drejtimi. P.sh., nxënësit që përfundojnë nivelin I të drejtimit mësimor “TIK”, mund të vijojnë nivelin III në një nga profilet mësimore si “Instalim dhe mirëmbajtje rjetesh kompjuterike”, “Mbështetje e përdoruesve të TIK” etj.

- Lënda “Mbrotjtja e mjedisit” klasa XIII (që ishte e përfshirë në skeletkurrikulat e strukturës 2+2 dhe bllok 4 vjeçar), të zëvendësohet me lëndën “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”.

Programi sintetik i kësaj lënde do të përfshihet në skeletkurrikulat e reja dhe të rishikuara të nivelit III.

- Për disa lëndë të veçanta (“Bazat e sipërmarrjes” klasa XIII, “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm” klasa XIII etj.), AKAFPK do të ofrojë programet analitike përkatëse.
- Për modulet e praktikave profesionale në të gjitha nivelet, shkollat ta përzgjedhin vetë mënyrën më optimale për t’i realizuar ato (të grupuara, të shpërndara, në mjediset e praktikave të shkollës, në biznese etj.).
- Për modulet praktike me zgjedhje të detyruar, përveç moduleve me zgjedhje që përmban skeletkurrikuli përkatës, mund të hartohen/propozohen edhe module të tjera të cilat janë të rëndësishme për formimin e nxënësve, brenda numrit të orëve të parashikuara.
- Klasa XIII e arsimit profesional, për të gjitha strukturat, të punojë me skeletkurrikulat e Nivelit III.
- Të gjitha shkollat profesionale të punojnë me planet mësimore të miratuara në udhëzimin e vitit shkollor 2011-2012. Shkollat profesionale kanë të drejtë të zgjerojnë listën e lëndëve me zgjedhje në kulturën e përgjithshme duke përdorur menynë e gjimnazit për lëndët me zgjedhje të detyruar, të përshtatura nga vetë shkollat.
- Për shkollat profesionale, klasa XIII, struktura 2+1+1, të zbatohet programi i historisë së gjimnazit, klasa XII “Historia e shqiptarëve”. Për lëndën gjeografi klasa XIII, strukturat 2+1+1, 2+2 dhe bllok 4 vite, të zbatohet programi i lëndës “Gjeografia e Republikës së Shqipërisë dhe e trevave të tjera shqiptare” të gjimnazit, klasa XII.
- Për profilin “Instalues hidrosanitar”, shkollat të punojnë me skletkurrikulën e përgatitur me mbështetjen e specialistëve të Programit AlbVET. Drejtoritë e shkollave dhe departamentet e lëndëve profesionale, të përgatisin kurrikulin përkatëse të klasës XIII (profili i përzgjedhur).
- Llogaritja e krediteve dhe e pikëve për shkollat profesionale, artistike dhe sportive bëhet si në gjimnazin me kohë të plotë. (Të gjitha lëndët kanë koeficientin 1)

3.7 Arsimi parauniversitar privat

- Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore të mbajnë kontakte të vazhdueshme me të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar privat dhe të bashkëpunojnë me to për realizimin e planeve mësimore, programeve mësimore si dhe veprimtarive jashtëshkollore.
- Të bëhet kujdes në zbatimin e Ligjit për arsimin parauniversitar ku sanksionohet se institucionet arsimore private zbatojnë planet dhe programet mësimore të miratuara në momentin e licencimit. Për çdo ndryshim kërkohet miratimi i ministrit.
- DAR/ZA-të të evidentojnë, të orientojnë dhe të kontribuojnë në realizimin e kërkesave të kualifikimit dhe të zhvillimit profesional të stafeve pedagogjike të institucioneve parauniversitare private.
- Nga ana e tyre institucionet arsimore parauniversitare private të zbatojnë me korrektësi detyrimet ndaj DAR/ZA-ve si dhe detyrimet e tjera në përdorimin dhe ruajtjen e dokumentacionit sipas Udhëzimit të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr.33, datë 01.11.2010 “Për kriteret dhe procedurat e shqyrtimit të kërkesave për licensë të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare”.

KREU IV

STRATEGJI, NDËRSEKTORIALE

1. Shërbimi psikologjik shkollor

- 1.1 DAR/ZA-të dhe drejtoritë e shkollave të marrin masa për konsolidimin e shërbimit psikologjik shkollor dhe realizimin e të gjitha detyrave të psikologut në zbatim të Udhëzimit Nr. 18, datë 21.04.2008 "Për funksionimin e shërbimit psikologjik shkollor në sistemin arsimor parauniversitar".
- 1.2 Psikologu shkollor të angazhohet në trajtimin e problemeve që kanë të bëjnë me sigurimin e të drejtës për arsim me fokus fëmijët me aftësi të kufizuar, fëmijët romë, egjiptianë dhe fëmijët në nevojë.
- 1.3 Të gjitha shkollat ku funksionon shërbimi psikologjik shkollor, të ngrenë grupin mbështetës të psikologut për zgjidhjen e problemeve të ndryshme që dalin.

2. Zbatimi i Planit të veprimit për reduktimin në zero të braktisjes shkollore 2009-2013

Në zbatim të Planit të Veprimit për braktisjen zero, DAR/ZA-të dhe shkollat këtë vit shkollor të marrin këto masa:

- a) Të koordinojnë bashkëpunimin ndërsektorial ndërmjet Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve (NJMF), të Pushtetit Vendor, institucioneve të shoqërisë civile, për zgjidhjen e problemeve të nxënësve braktisës.
- b) Të organizojnë fushata lokale të komunikimit për reduktimin e braktisjes shkollore.
- c) Të ndjekin me përparësi arsimimin e nxënësve të ngujuar, në përputhje me Udhëzimin Nr. 9, datë 11.04.2007 "Për arsimimin e nxënësve të ngujuar për shkak të gjakmarrjes".
- d) Të mbështesin me përparësi e funksionimin e klasave të "Shansit të dytë" në zbatim të Udhëzimit Nr. 34, datë 08.12.2004 "Për zbatimin e projektit "Shansi i dytë", me synimin e riintegrimin e këtij kontigjenti në klasat normale.
- e) Të raportojnë në MASH, dy herë në vit (në fund të semestrit të parë dhe në fund të vitit shkollor), për realizimin e këtij plani, sipas formatit përkatës.

3. Zbatimi i Programit Kombëtar COMBI "Për një shkollë miqësore pro sjelljeve pozitive"

Në përfundim të zbatimit të fazës së parë të programit kombëtar COMBI, në DAR/ZA, në drejtoritë e shkollave dhe në kopshte gjatë këtij viti të ndiqet me përparësi:

- a) Organizimi mujor i bisedave kafe dhe diskutimi i rasteve të zbatimit të MRD-së.
- b) Monitorimi i standardizuar i ecurisë së programit.
- c) Organizimi i aktiviteteve lokale informuese dhe sensibilizuese, në nivel DAR/ZA-je, shkolle dhe kopshti me përfshirjen e gjerë të komunitetit të prindërve, për ecurinë e zbatimit të MRD-së.

4. Zbatimi i strategjive ndërministrore

MASH është pjesë e hartimit dhe zbatimit të strategjive kombëtare ndërministrore të Qeverisë Shqiptare, si:

- a) Strategjia Kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom si dhe Plani i Veprimit të Dekadës Rome.

- Plani i Veprimit të MASH-it, nr.3822, datë 03.06.2010, për realizimin e objektivave dhe treguesve të Planit të Veprimit “Dekada e përfshirjes së romëve”.
 - Plani i Veprimit të MASH-it, për zbatimin e rekomandimeve të “Seminarit mbi ndërgjegjësimin për përfshirjen e komunitetit Rom dhe Egjiptian, në kuadër të integritimit të Shqipërisë në BE”.
- b) “Strategjia Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuar”.
- DAR/ZA-të, drejtoritë e shkollave dhe kopshteve integritimit me përparësi të këtij kontingjenti nxënësish në klasat normale.
 - Drejtuesit e institucioneve arsimore kanë përgjegjësinë për të krijuar kushtet e nevojshme që nxënësit me AK të trajtohen nga mësuesit dhe psikologu i shkollës me plan edukativ individual.
- c) Strategjia “Për riintegrimin e emigrantëve shqiptarë të kthyer 2010-2015”;
- Përditësimi i statistikave për nxënësit e ardhur nga jashtë vendit, grupmosha dhe ecuria e tyre në procesin mësimor-edukativ.
 - Krijimi i mundësive përmirësimin e njohurive në gjuhën amtare si dhe në lëndët e tjera ku ata kanë nevojë.
- d) Strategjia Kombëtare Antitrafik 2012-2013.
- Shpërndarja e materialit udhëzues për detyrimet e MASH dhe institucioneve të varësisë në luftën antitrafik.
 - Monitorimi i veprimtarive në kuadër të edukimit antitrafik dhe trajnimi i drejtuesve të shkollave të arsimit parauniversitar, në bashkëpunim me OJF-të e specializuara në këtë fushë dhe me MB.
- e) Strategjia për Edukimin për Sigurinë Rrugore.
- f) Strategjia për luftën kundër përdorimit të drogës dhe alkoolit.
- g) Strategjia Kombëtare e Barazisë Gjinore, Reduktimit të Dhunës me Bazë Gjinore dhe Dhunës në Familje.
- h) Marrëveshja e bashkëpunimit nr. 2208/3, datë 20.04.2012, mes MASH dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për zbatimin e programit “Edukimi, ndërgjegjësimi dhe reduktimi i kërkesës për drogë dhe substanca të tjera të rrezikshme”.
- i) Plani i masave për mosdiskriminimin për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor.
- j) Plani i ri kombëtar për ushqimin dhe ushqyerjen.

5. DAR/ZA-të, sipas udhëzimeve të dhëna nga MASH:

- a) të caktojnë një person përgjegjës për ndjekjen e këtyre strategjive.
- b) të hartojnë plane pune vjetore me detyra konkrete, sipas planit të aktiviteteve të çdo strategjie.
- c) të monitorojnë zbatimin e detyrimeve që lindin nga këto strategji në nivel shkolle dhe në nivel DAR/ZA-je.
- d) të raportojnë në MASH, në përfundim të çdo semestri, për veprimtaritë dhe për të dhëna statistikore për çdo strategji.
- e) Për realizimin e detyrimeve që lindin nga këto strategji, MASH, DAR/ZA-të dhe shkollat, të bashkëpunojnë edhe me OJF-të e specializuara dhe të interesuara në këto fusha. Bashkëpunimi të mbështetet në marrëveshje, memorandume dhe projekte dy ose shumëpalëshe, të nënshkruara ose miratuara domosdoshmërisht nga MASH-i.

6. Projekte për zbatim

1. Në kuadër të nënshkrimit të marrëveshjes së Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës me Fondacionin Shqiptaro – Amerikan për Zhvillim, për vitin shkollor 2012-2013 do të

- zbatohet edhe **programi “Arritje Rinore”** (Junior Achievement) në kurrikulën me zgjedhje të lirë, në klasat XI dhe XII të shkollave të përzgjedhura në këtë projekt.
2. Të gjitha shkollat e përzgjedhura të krijojnë mundësinë e zbatimit të këtij projekti dhe të marrin masa për krijimin e dy klasave (një klasë e 11-të dhe një klasë e 12-të) që do të zgjedhin modulet e programit **“Arritje Rinore”**.
 3. Shkollat e mesme profesionale me drejtim **“Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”**, të përdorin programin mësimor dhe materialet didaktike të cilat u përgatitën në kuadër të projektit **“English For Skills”** në bashkëpunim me Këshillin Britanik, për gjuhën e huaj angleze, klasa XII, për një semestër (18 javë). Moduli do t’i dërgohet secilës shkollë në version të printuar dhe elektronik përpara fillimit të vitit shkollor. Drejtoritë e shkollave të kenë parasysh përdorimin e këtij moduli për përgatitjen e dokumentacionit shkollor (plane dhe regjistra). DAR/ZA-të dhe IKAP-i të kenë parasysh këtë modul gjatë punës së tyre monitoruese/inspektuese.
 4. Shkollat profesionale me drejtim **“Termohidraulikë”** të vazhdojnë mësimet me programet e hartuara nga projekti zviceran ALBVET dhe miratuara nga MASH. Këto shkolla të realizojnë praktikat profesionale sipas planifikimit të realizuar nga ky projekt.
 5. Moduli **“Ju dhe biznesi”**, hartuar nga Dhoma e Tregtisë Durrës, të përfshihet në listën e moduleve me zgjedhje të lirë të gjimnazit.
 6. Të përfshihen në gjimnaze, në përshtatje me kushtet përkatëse, në kurrikulën me zgjedhje të lirë, 10 programet e moduleve profesionale për të cilët janë bërë trajnimet e nevojshme sipas listës së mëposhtme (pjesë e kurrikulës me zgjedhje të lirë)
 - a) Punime të mirëmbajtjes dhe riparimit në banesa.
 - b) Etika e të veshurit dhe arredimit.
 - c) Veprimtari në shërbimin e klientit.
 - d) Estetika dhe truku.
 - e) Veprimtaritë bujqësore.
 - f) Veprimtari ndihmëse në laborator.
 - g) Kujdesi për kafshët e shoqërimin.
 - h) Asistencë zyre.
 - i) Përpunim i produkteve ushqimore.
 - j) Punime të riparimit dhe mirëmbajtjes mekanike.

Shënim. Materialet e plota për këto module gjenden në: www.izha.edu.al

KREU V

VEPRIMTARI SHKOLLORE DHE JASHTËSHKOLLORE ME KARAKTER EDUKATIV

1. Veprimtari edukative, qeveria e nxënësve dhe bordet e prindërve

- a) **Zbatimi me përparësi i planit të aktiviteteve edukative, projekteve kurikulare dhe veprimtarive ekstrakurikulare, në kuadrin e 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë.**
 - Zhvillimi i konkursit rajonal për esenë më të mirë me temë: **“Kombi shqiptar 100 vjet pas shpalljes së Pavarësisë”**.
 - Zhvillimi i konkursit rajonal në fushën e historisë me temë **“Shqiptarët 100 vjet pas shpalljes së Pavarësisë”**;

- Zhvillimi i një aktiviteti “Flamurtari i qytetit”, ku nxënësi me arritjet më të mira dhe nxënësit më të spikatur të marshojnë në një ceremoni festive në qytet.
 - Zhvillimi i një konkursi rajonal në fushën e pikturës, skulpturës, vizatimit që kanë për temë “100 vjet shtet i pavarur shqiptar”.
 - Mbledhja e dokumenteve për rolin që ka luajtur në luftën për pavarësi, qyteti/fshati apo krahina juaj;
 - Evidentimi i figurave të njohura të rajonit tuaj në Pavarësinë e shtetit shqiptar dhe në konsolidimin e tij;
- b) Veprimtari ndërgjegjësuese për Ditën e Romëve, Ditën e aftësisë së kufizuar dhe autizmit, Ditën e barazisë gjinore, Ditën e luftës kundër dhunës, trafikimit, duhanit, alkoolit, SIDA-s etj.
- c) Organizimi dhe menaxhimi i fazave përgatitore dhe fazës finale të olimpiadave kombëtare në lëndët “Matematikë”, “Fizikë”, “Kimi”, “Biologji” dhe “Informatikë”. Të gjitha olimpiadat të realizohen në përputhje me Rregulloren Nr. 2264/1, datë 05.04.2010 “Për zhvillimin e olimpiadave të lëndëve shkencore në arsimin parauniversitar”.
- d) Veprimtaritë gjithëvjetoare në fushën e gjuhëve të huaja në kuadrin e 10-vjetorit të Ditës Europiane të Gjuhëve.
- e) Planifikimi i veprimtarive kulturore – sportive në nivel DAR/ZA-je dhe shkolle.
- f) Planifikimi i veprimtarive intensive gjithëvjetoare për edukimin për karrierën veçanërisht me nxënësit e klasës së 9-të dhe nxënësit e klasës së 12-të për t’i informuar rreth mundësive të mëtejshme të shkollimit dhe punësimit.
- g) Veprimtaria e Qeverisë së nxënësve dhe organizimi i prindërve
- Qeveria e nxënësve është organizëm që mbron dhe promovon të drejtat e nxënësve dhe ndihmon në mbarëvajtjen e shkollës. Ajo ngrihet dhe funksionin në përputhje me Ligjin e Arsimit Parauniversitar, urdhrat dhe udhëzimet e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.
 - Kryetari i qeverisë së nxënësve në arsimin e mesëm të lartë të zgjidhet nga nxënësit me votë të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë.
 - Në shkollë mund të funksionojnë edhe organizime të tjera të nxënësve, të ngritura për interesat e tyre shkencore, kulturore dhe sportive.
 - MASH, DAR/ZA-të dhe shkollat të bashkëpunojnë me organizmat vendorë dhe jofitimprurës për forcimin e veprimtarisë së qeverisë së nxënësve, mirëfunksionimin e saj dhe shkëmbimin e eksperiencave në këtë fushë në nivel rajonal e kombëtar
 - Promovimi i funksionimit të qeverisë së nxënësve duke marrë si model DAR-të Kukës dhe Korçë.
 - MASH të nxitë dhe të përkrahë organizimin e prindërve, si një mundësi e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të komunitetit në veprimtarinë mësimore dhe edukative të shkollës.
 - Në këtë kuadër, me interes do të ishte krijimi i një forumi më të gjerë këtij organizimi, Bordet Rajonale të Prindërve pranë DAR/ZA-ve.
 - Bordet Rajonale të përfaqësojnë interesat e prindërve të rajonit ku veprojnë, dhe të kenë për qëllim ndërtimin e një partneriteti të qëndrueshëm me institucionet rajonale arsimore dhe aktorëve të tjerë vendorë, me synim përmirësimin e cilësisë së procesit mësimor-edukativ, duke marrë si model përvojën e DAR-ve Kukës, Korçë dhe Gjirokastrë.

2. Veprimtaritë në kuadër të presidencës së Këshillit të Europës

MASH, si pjesë e grupit ndërministror të realizimit të presidencës shqiptare në Këshillin e Europës, udhëzon DAR/ZA-të:

- a) Të nxisin, të promovojë dhe demonstrojnë në mjediset shkollore të gjitha projektet dhe bashkëpunimet me Këshillin e Europës.

- b) Në zbatim të trajnimit të zhvilluar nga Këshilli i Europës në Tiranë në 26 qershor 2012 të marrin masa për njohjen e mësuesve të lëndëve shoqërore dhe nxënësve me informacionet e ofruara nga KiE përmes internetit për promovimin e edukimit për një qytetari demokratike dhe njohjes të të drejtave të njeriut në Shqipëri.
- c) Të marrin masa për planifikimin e veprimtarive në kuadër të Ditës Europiane të Gjuhëve, më 26 shtator 2012, duke theksuar rëndësinë e shumëgjuhësisë dhe respektimin e kulturave të tjera.
- d) Të marrin masa për përdorimin dhe promovimin përmes projekteve kurrikulare të Portofolit Europian të Gjuhëve në shkollat e arsimit parauniversitar.
- e) Të planifikojnë veprimtari në kuadër të “Përkujtimit të Holokaustit dhe krimeve kundër njerëzimit”.
- f) Të respektojnë rolin e gjuhëve të minoriteteve në zbatim të kërkesave të “Kartës Europiane për Minoritetet” dhe angazhimeve që dalin prej saj.
- g) Të zbatojnë planin e veprimtarive të Dekadës Rome.

KREU VI

ROLI DHE DETYRAT E STRUKTURAVE INSPEKTUESE

Inspektorati Kombëtar i Arsimit Parauniversitar (IKAP), sipas një plani aktiviteteve të miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, gjatë vitit mësimor 2012-2013 të ketë si përparësi inspektimin e:

- a) plotë, tematik dhe të orientuar të kopshteve, të shkollave të arsimit bazë dhe atij të mesëm;
- b) procesit të përzgjedhjes së ALTERTEKSTIT dhe shpërndarjes së librit shkollor;
- c) procesit të pajisjes së bibliotekave shkollore me literaturë artistike, shkencore dhe didaktike sipas listës orientuese të miratuar nga MASH;
- d) Provimeve të Lirimit dhe të Maturës Shtetërore;
- e) plotë dhe të orientuar të DAR/ZA-ve;
- f) arsimit publik dhe privat parauniversitar, me kohë të plotë e të pjesshme;
- g) zbatimit të ligjshmërisë në institucionet e arsimit parauniversitar;
- h) efektivitetit të përdorimit të laboratorëve të informatikës dhe atyre shkencorë;
- i) cilësisë së mësimdhënies/nxënies;
- j) raporteve të vlerësimit të brendshëm dhe ritmikën e këtij vlerësimi, sipas formateve dhe materialeve me të cilat janë pajisur këto institucione, të tilla si:
 - Udhëzues zyrtarë të vlerësimit të kopshteve, të shkollave dhe të DAR/ZA-ve,
 - “Metodologjia e inspektimit dhe vlerësimit të brendshëm të institucioneve të arsimit parauniversitar”.

KREU VII

REGJISTRIMET DHE PAJISJA E NXËNËSVE ME TEKSTE SHKOLLORE

1. Regjistrimet e nxënësve në shkollat e arsimit parauniversitar të fillojnë më datën 29.08.2012 dhe të mbyllen:
 - në datën **09.09.2012** për arsimin bazë dhe gjimnazin.
 - në datën **30.09.2012** për arsimin profesional me kohë të plotë.
 - në datën **15.10.2012** për arsimin profesional me kohë të pjesshme.
2. DAR/ZA-të, në bashkëpunim me pushtetin vendor, të sigurojnë regjistrimin e nxënësve në përshtatje me vendbanimin e tyre.

3. Regjistrimi i nxënësve të arsimit bazë, që vijnë nga shkolla të tjera, të bëhet me fletëpranim dhe fletëshpërngulje, të cilat do të evidentohen me rigorozitet në balancimin e kontingjentit të nxënësve.
4. DAR/ZA-të, sipas afateve të përcaktuara në formularin operativ “Lëvizja dhe balancimi i kontingjenteve të nxënësve” dhe detyrimeve për reduktimin në zero të braktisjes shkollore, të dërgojnë në MASH të dhënat mbi lëvizjet e nxënësve të arsimit bazë.
5. DAR/ZA-të të marrin masa që:
 - a) Drejtoritë e shkollave të monitorojnë pajisjen e nxënësve me tekstet shkollore dhe të informojnë DAR/ZA-të për ecurinë e procesit.
 - b) DAR/ZA-të të njoftojnë zyrtarisht Komisionin e Miratimit të Teksteve (KMT) në MASH për ecurinë e procesit të furnizimit të nxënësve me tekste shkollore si dhe problematikat e mundshme (mungesë tekstesh, shitje librash jashtë katalogut, shitje pa faturë etj.).
 - c) Drejtoritë e shkollave të fillojnë punën që në ditët e para të fillimit të vitit shkollor për zbatimin e Udhëzimit të përbashkët të MASH-it dhe Ministrisë së Financave Nr. 15, datë 28.05.2010 “Për procedurat e përdorimit të fondeve të buxhetit të shtetit për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve të arsimit parauniversitar dhe universitar”.

KREU IX

DISPOZITA TË FUNDIT

Për zbatimin e këtij Udhëzimi ngarkohen:

1. MASH, IZha, IKAP, AKAFP, AKP, DAR/ZA-të dhe shkollat.
2. DAR/ZA-të të marrin masat e duhura që ky Udhëzim të shpërndahet në çdo shkollë dhe me përmbajtjen e tij të njihet çdo punonjës i arsimit.

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MYQEREM TAJAJ

MINISTËR

